

DHUNA FAMILJARE

DHUNA NUK ËSHTË VETËM PROBLEMI IM

*Ç'ka është dhuna familjare

*Cila mund të jetë viktimja e dhunës në familje?

*Si mund të zbulohet dhuna në familje?

*Elementet e dhunës në familje

*Plani për siguri

*Ç'ka mund t'i tregoni viktimës nga dhuna në familje?

Ç'ka është dhuna në familje?

Të gjitha kontaktet e rrezikshme, apo kërcënimet mes anëtarëve të familjes, ose mes bashkëshortëve dëshmojnë dhunën në familje, duke patur parasysh edhe dëmet materiale (pasurinë), metodën e kontrollës, hakmarrjes apo dënimet. Dhuna në familje përfshinë-rrahjen, fyerjen, rënien me shuplakë ose shkuljen e flokëve. Si mjete për kërcënim mund të shërbejnë edhe sendet e rëndomta, por edhe armët. Dhuna në familje përfshinë fyerjet emocionale dhe verbale (inferioritetin verbal) ose dhunën seksuale (akt seksual i padëshiruar).

Cila mund të jetë viktimë e dhunës në familje?

Secili mund të jetë viktimë e dhunës në familje. Dhuna është një fenomen që mund t'i ndodh ç'dokujt pa patur parasysh moshën apo grupën sociale ose ekonomike. Kjo mund t'ju ndodh edhe njerëzve me shkallë të ndryshme arsimimi.

Rreziku mund t'ju kërcënohet të gjithë anëtarëve të familjes në mënyrë të balancuar.

Si mund të zbulohet dhuna në një familje?

Mundet ke qenë viktimë e dhunës në familje. Dhunën në familje e ke përjetuar nëqoftëse:

- ndonjëherë ke qenë e detyruar fizikisht të veprosh kundër dëshirës dhe vullnetit tënd ose ke qenë e keqtrajtuar apo e ofenduar;
- të kanë rënë me shuplakë, me grusht, ke qenë e shtyer, e grithur, e ndukur, të kanë rënë me ndonjë send(mjet), e qëlluar me armë, e shpuar me thikë apo nëse psikikisht dikush të ka ofenduar;
- të kanë detyruar të bësh marrëdhënie seksuale ose ndonjë veprim tjetër seksual pa dëshirën tënde;
- ke tremë (frikë) të takohesh me miqtë ose me anëtarët e familjes se mund të hidhërohet partneri yt ose nëse ke qenë e fyer nga partneri për arsye se takohesh me miqtë apo me anëtarët e tjerë të familjes;
- kjo ka ndodhur prej kur je në këtë lidhje ose mundet je psikikisht e ofenduar. Dhunën psikike e ke përjetuar prej momentit kur je futur në këtë lidhje. Dhuna psikike përbën fyerjen verbale, ofendimet, manipulimet, ose izolimin nga miqtë dhe nga familjarët.

Elementet e dhunës në familje

- *Kontrollimi dhe fuqia*

Kontrollimi dhe fuqia fizike janë dy faktorë në një moment dhune. Viktima në të shumtën e rasteve është e detyruar ta duron dhunën.

- *Dhuna fizike:*

Dhunuesi përdor forcën me qëllim që ta frikon viktimën. Kjo i ndërlidh këto veprime: shtyerjen, rrahjen, rrahjen me pëllëmbë të dorës, shkuljen e flokëve, rrahjen me grushta, shfrytëzimin e armës, dhe disa veprime të tjera dhune.

- *Dhuna emocionale:*

Ai që përdor dhunën e nënvleftëson ose e vëndon në pozitë inferiore viktimën, e fyer me fjalë të këqia ose e trajton si njeri me sëmundje mentale (psiqike).

- *Kërcënimet:*

Dhunuesi e fyer emocionalisht viktimën dhe i kërcënohet se do t'ia merr fëmijët dhe i kërcënohet se do ta vret.

- *frikëshimi*

Individi e detyron të qaj viktimën me veprime të çuditshme (të jashtëzakonshme), me gjeste ose duke u çjerrë, duke thyer sende nga orënditë apo suveniret shtëpiake (pronësinë).

- *Dhuna ekonomike:*

Individi nuk e lejon viktimën të punësohet ose ta ruan vendin e punës. Individi mund t'ia mer begatinë materiale.

- *Dhuna seksuale*

Individi e detyron viktimën, përkundër vullnetit të saj të bën marrëdhënie seksuale, ose fizikisht e keqtrajton trupin e viktimës.

- *Izolimi:*

Dhunuesi e ndjek viktimën e vëren se me kë takohet viktima dhe me kë bisedon.

Dhunuesi shpesh herë i shfrytëzon fëmijët si motiv për të vepruar kundër viktimës ai e fajëson gruan për sjelljen e keqe të fëmijëve, i shfrytëzon fëmijët për të dërguar fjalë (porosi) dhe i keqtrajton fëmijët me qëllim që ta sulmon atë. Ai e shfrytëzon fuqinë fizike dhe e trajton gruan si shërbëtore, vet merr vendime ose sillet si "pronar që dominon".

**DHUNA NUK ËSHTË E RASTIT.
AJO ZHVILLOHET GRADUALISHT DHE NË TË SHUMTËN E RASTEVE
DHUNA KA PIKA TË PËRBASHKËTA KARAKTERISTIKE PËR ZHVILLIM:**

- *Ndërtimi i skenës*

- Dhunuesi është i frustruar dhe rritet shqetësimi te ai, bëhet xheloz dhe ofendon në mënyrë verbale.
- Rritet tensioni mes partnerëve
- Viktima nuk e pranon frikën ,as hidhërimet, as egzistimin e dhunës.
- Viktima mund ta merr përgjegjësinë për ç'do problem dhe mundohet ta ruaj paqen.

- *Stadioni i dhunës akute*

- Tensionet bëhen të padurueshme
- Dhuna më së shumti manifestohet në këtë kohë. Shpesh herë viktima dhe dhunuesi kontaktojnë me policinë, mjekët dhe këshilltarë të ndryshëm që janë ekspert për këta probleme.
- Në këto raste qëllimi kryesor i viktimës është ta përjeton dhunën. Ikja është e pamundur. Viktima shpesh hesht duke menduar se do ngadalësohet "Furtuna".
- Viktima mund të kalon nga ana e atij që dhunon dhe t'i largohet bashkëpunimit me ata që duan të ndihmojnë.

- *Stadioni i luleve dhe e dashurisë*

- Dhunuesi shpesh pendohet dhe paraqitet si i këndshëm dhe i kujdesshëm.
- Dhunuesi premtan se do ndryshon dhe kurrë nuk do të vepron aq keq.

Ç'ka përfshin plani për sigurim?

Të gjithë viktimat e dhunës duhet të përgadisin plan për sigurim. Ajo mund të jetë një copë letër ku do të identifikoheshin disa emra dhe numrat e telefonave të SOS-it ,avokatëve, organizatave të grave të cilat veprojnë në këtë drejtim(për siguri gjinore) dhe numrat e të punësuarve social për bashkëshortësi dhe familje.

Nëqoftëse hartoni planin për siguri:

- *Duhet patur parasysh rrugët e mundshme për të ikur. Dyert, dritaret, daljet nga podrumet, ashensorët dhe shkallët.*
- *Zgjidhe vendin ku mund të shkosh. Në shtëpinë e ndonjë miku apo farefisi që mund të të përkrah, ose ndonjë hotel. E rëndësishme është të ndjehesh e sigurt.*
- *Futni në ndonjë valixhe gjërat më të domosdoshme. Siguro para për taxi, çelsa rezervë të shtëpisë, të banesës ose veturës, çertifikatën e lindjes, pashaportat, barërat për mjekim, të dhënat për sigurimin tënd social, disa dokumente si p.sh. vendimin e gjykatësit për shkurorëzim (nëse është miratuar), notesin, pasurinë e patundshme, dhe dokumentin për ate që posedoni me bashkëshortin. Të gjitha këto ose disa prej tyre mund t'i lini te fqiu që keni besim ose te farefisi, poashtu mund t'i lësh edhe te sefi i ndonjë banke.*
- *Mundohu të krijosh mjete materiale. Të ardhurat tua jepja dikujt t'i ruan, ndonjë miku apo ndonjë njeriu nga farefisi më i afërt.*
- *Largoju bisedimeve me dhunuesin kur bëhet fjalë për vendet ku ruhet arma. Si p.sh. kuzhina, garazha, ose vendet e tjera shumë të vogla që nuk kanë dalje.*
- *Mbaje mend numrin e linjes S O S për viktimat nga dhuna në familje. Kontakto me ato në lidhje me të drejtën rregullare dhe për informata tjera që të duhen.*

Ç'ka mund t'i tregoni viktimës nga dhuna në familje?

- Më brengos siguria jote.
- Më brengos siguria e fëmijëve të tu.
- Situata mund të keqësohet në të ofrojmë ndihmë, kur duhet ta lëshojsh shtëpinë etj.
- Ti meriton diçka shumë më të mirë se kjo.

TI NUK MERITON TORTURA

ASKUSH NUK DUHET TË MALLTRETUHET

**ASOCIACIONI PËR EMANCIPIM, SOLIDARITET DHE BARAZI TË GRAVE TË
REPUBLICËS SË MAQEDONISË**

Adresa:

“Maksim Gorki” 20 1/4

1000 Shkup

Republika e Maqedonisë

Tel. ++ 389 (0)2 298295

++ 389 (0)2 298296

Fax ++ 389 (0)2 211453

www.esem.org.mk

esem@unet.com.mk